



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:087094

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05390077

KPPP.nr.825/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturina Ekoregjioni” SH.A., me NUI: 811324152, me seli në rr. “Tahir Sinani”, në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.S., avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Klinaku & Associates L.L.C.”, me NUI: 810828999, me seli në rr. “De Rada, Nr. 4” në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.149/2022 të datës 01.04.2022 të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 28.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Klinaku & Associates L.L.C.” ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.149/2022 i datës 01.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesit Privat Enis Hoxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturina Ekoregjioni” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.149/2022 të datës 01.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me nr. PZ21103233 të datës 31.10.2021 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të paguara nga fatura nga dita e pranimi të këtij urdhri të paguajë detyrimin në shumën prej 247.49 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen me bllokimin e të gjitha llogarive

bankare të debitorit deri në pagimin e shumës totale të detyrimit, ndërsa nëse nuk ka mjete të mjaftueshme në llogari bankare, atëherë përbarimi të zbatohet në tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, duke theksuar ndër të tjera se fatura nuk është e përshtatshme për përbarim dhe se dokumenti në bazë të cilit kreditori kërkon përbarimin nuk është dorëzuar në origjinal. Më tutje ka deklaruar se debitori shërbimet komunale të mbeturinave i ka shfrytëzuar në periudhën kohore prej datës 01.01.2018 deri më 01.07.2019. Ka shtuar se asnjëherë paraprakisht nuk ka pranuar ndonjë faturë lidhur me këtë borxh i cili është parashkruar konform nenit 360 parag. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit ndërsa urdhri për përbarim të shfuqizohet si i pa bazuar dhe të hidhet poshtë si dhe të anulohen të gjitha veprimet e kryera.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se ky urdhër është nxjerrë në bazë të dokumentit të besueshëm faturave të dorëzuara në origjinal dhe kartelën e konsumatorit. Në lidhje me pretendimet e debitorit se kërkesa e borxhit është parashkruar e njëjta nuk qëndron, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me biznes e cila bie në kategorinë e shërbimeve komerciale, e në anën tjetër kreditore është i obliguar që në tërë territorin të kryej shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, andaj çdo biznes është i obliguar të paguaj mbeturinat. Në fund ka deklaruar se të gjitha faturat janë të përshtatshme për përbarim me arsyetimin se në të tregohen palët, mjeti, objekti, shuma dhe janë të pranuar në mënyrë të rregullt dhe si të tilla janë të përbarueshme. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri për përbarim, si dhe të obligohet debitori që të paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim si dhe të gjitha shpenzimeve tjera deri në përfundim të kësaj çështje përbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit

është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet dhe procedura përbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr. PZ21103233 e datës 31.10.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr. PZ21103233 të datës 31.10.2021 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura e lartcekura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt këtë faturë, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilën mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi Privat ka lejuar përbarimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Meqenëse gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi për këto arsye, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me parashkrimin e kërkesës.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.825/23 datë 28.02.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.